



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 2, datë 01. 03. 2012

PËR

**“MARRJEN NË PRONËSI NGA BASHKIA E TIRANËS TË AKSIONEVE TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE SHA TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8 pika 1/II shkronja “a” dhe “c”, nenit 10, pika 3/I shkronja “a” dhe “b”, nenit 72, pika 5/I shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 4 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.500, datë 14.8.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.9.2007 për “Transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore”; udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës nr. 965, datë 11.12.2007, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 03.10.2007 për “Një shtesë në vendimin nr.271, datë 9.5.1998 të këshillit të ministrave për "miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore"; urdhërit nr.1041, datë 19.12.2007 për “ Ndryshime në statutin e shoqëriseë anonime “Ujesjellës-kanalizime” Tiranë sha”, Këshilli Bashkiak pasi mori në konsideratë propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë marrjen në pronësi nga ana e Bashkisë së Tiranës të 72.5% të aksioneve të shoqërisë “Ujësjetllës kanalizimeve sha Tiranë”.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse për ndjekjen e procedurave ligjore për reflektimin e vlerave përkatëse sipas ligjit “Për kontabilitetin”.
3. Të miratojë 4 anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për Bashkinë e Tiranës si më poshtë:
 1. Etion Kapedani
 2. Taulant Zeneli
 3. Florian Pustina
 4. Gjergj Bakëllbashi
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për të përfaqësuar Bashkinë e Tiranës në mbledhjen e asamblesë dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI